

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-203/14

Prishtinë

25 Janar 2017

Në çështjen juridike të:

S.M.

Rruga “Ace Joksimovića 58/24”

Beograd

Pala ankuese

kundër

Komuna e P.

Përfaqësuar nga: F.R. (Përfaqësues ligjor i Komunës)

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit i AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 të datës 27 nëntor 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin 33935), pas shqyrtimit të mbajtur më 25 janar 2017, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga S.M. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 të datës 27 nëntor 2013, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA33935, refuzohet si e pabazuar
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 i datës 27 nëntor 2013, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA33935, anulohet *ex officio* dhe kërkesa e lartcekur hidhet poshtë në mungesë të juridiksionit.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 31 maj 2007, S.M. (më tutje: pala ankuese) duke vepruar në emër të babait të saj të ndjerë R.O., fillimisht ka paraqitur kërkesë me numrin KPA33935 në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e ngastrave kadastrale me numrat 503/1, 503/2 dhe 504 me sipërfaqe totale prej 00.76.36 ha, që ndodhet te vendi i quajtur “Çikovac kod kuçe”, fshati Shajkovc, Komuna e P. . Pala ankuese deklaroi se babai i saj i ndjerë është pronar i pronave të kërkuara dhe se humbja e posedimit ndërlidhet me konfliktin e armatosur në Kosovë në vitet 1998/99, duke e cekur 4 korrikun 1999 si datën e humbjes.
2. Më pas, kërkesa fillestare u nda në kërkesë të re me numrin KPA93046 për ngastrën kadastrale nr.503/1 dhe 503/2. Pas ndarjes së kërkesës, kërkesa fillestare KPA33935 përmbante vetëm ngastrën kadastrale nr.504 me sipërfaqe prej 00.23.95 ha (më tutje: prona e kërkuar).
3. Për ta mbështetur kërkesën e saj, pala ankuese në AKP i dorëzoi këto dokumente:
 - Certifikatën e Martesës nr.266 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Prishtinës më 23 maj 1979 përmes së cilës dëshmohet lidhja familjare në mes të palës ankuese dhe R.O..

- Fletën Poseduese nr.140 të lëshuar nga Instituti i Gjeodezisë i Republikës së Serbisë, Zyra për Patundshmëri dhe Kadastër (Organi Paralel) më 26 prill 2007. Prona e kërkuar është regjistruar në emër të babait të palës ankuese.
4. Më 11 korrik 2013, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së bëri identifikimin e kërkesës. Nga gjetjet rezultoi se prona e kërkuar ishte e uzurpuar nga Kuvendi Komunal i P. (më tutje: pala përgjegjëse në ankesë). A.L., Drejtor i Departamentit për Çështje Pronësore dhe Gjeodezi, nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes në procedurën e AKP-së duke pretenduar se prona e kërkuar ka qenë në pronësi të Komunës së P. që nga viti 1960.
 5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e verifikoi pronën e kërkuar si në Zyrën Kadastrale të Komunës së P. ashtu edhe në Arkivin e Kadastrit të Zhvendosur në Kruševac, Serbi.
 - Sipas Certifikatës për të Drejtat e Paluajtshme Pronësore e verifikuar ex officio në Kadastrin Komunal të P. prona e kërkuar është e regjistruar në emër të palës përgjegjëse në ankesë. Nuk ka pasur informata se në bazë të cilit dokument është regjistruar prona e kërkuar si e tillë (raporti i verifikimit i datës 20 nëntor 2012).
 - Kadastri i Zhvendosur, ndërkaq, e verifikoi pronën e kërkuar në emër të babait të palës ankuese. Megjithatë, as Kadastri i Zhvendosur nuk posedon prova se në bazë të cilit dokument babai i palës ankuese u bë pronar i pronës së kërkuar (raporti i verifikimit i datës 2 tetor 2013).
 6. Rrjedhimisht, pala ankuese është kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së duke i kërkuar asaj që të ofrojë informata/dokumente shtesë lidhur me bartjen e të drejtës së pronësisë në emër të babait të saj. Pala ankuese deklaroi se është befasuar me gjetjet e Sekretarisë Ekzekutive pasi që prona e kërkuar ka qenë në posedim të pandërprerë dhe të papenguar të babait të saj, por ajo nuk ka dokument tjetër që të paraqes në Komision (faqe nr.253 dhe 254 të shkresave të lëndës).
 7. Më 27 nëntor 2013, Komisioni me vendimin e vet KPCC/D/A/220/2013 e refuzoi kërkesën me arsyetimin e paditësja nuk kishte arritur të dëshmonte pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit të viteve 1998-1999.
 8. Më 29 prill 2014, vendimi i KKKP-së iu dorëzua palës ankuese. I njëjti vendim iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më datën 14 prill 2014.
 9. Më 21 maj 2014, pala ankuese e paraqiti ankesën. Pala përgjegjëse e pranoi ankesën më 2 dhjetor 2014 ndërsa u përgjigj ndaj ankesës më 14 janar 2015.

Pretendimi i palëve

Pala ankuese

10. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është i bazuar në vërtetim të mangët të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
11. Pala ankuese pretendoi se nuk është i vërtetë arsyetimi i KKPK-së se Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka dështuar të sigurojë *ex officio* ndonjë provë që vërteton bazën ligjore për të drejtën e pronësisë të babait të saj.
12. Sipas saj, prona e kërkuar është regjistruar në emër të babait të saj në vitin 1992. Kjo është bërë në bazë të Aktgjykimit nr. 39/90 të lëshuar nga Gjykata Komunale e P. më 24 maj 1990 që u bë i formës së prerë më 27 shkurt 1991. Fatkeqësisht, ajo nuk e posedon Aktgjykimin e përmendur.
13. Në mbështetje të ankesës ajo dorëzoi:
 - Kopjen e listës së ndryshimeve me numër rendor 1 për vitin 1992 me numrin e referencës 1/2014-650 të datës 15 maj 2014 gjoja të lëshuar nga Kadastrin e Komunës së P. .
14. Në fund të ankesës së saj, pala ankuese ceku se prindërit e saj e kishin poseduar pronën e kërkuar deri në vitin 1999 kur ata u detyruan ta braktisin Kosovën dhe Gjykatës Supreme i propozoi që ta pranojë ankesën e saj si të bazuar dhe ta vërtetojë të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar në emër të babait të saj.

Pala përgjegjëse në ankesë

15. Më 27 qershor 2016, Komunës së P. iu dorëzua një Urdhër Gjykate. Ky urdhër gjykate thotë:

Gjykata Supreme kërkon nga Komuna e P. që brenda dy javësh nga pranimi i këtij Urdhri të dorëzojë në Gjykatën Supreme:

një autorizim të vlefshëm për F.R. për ta përfaqësuar Komunën e P. në këtë lëndë.
16. Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, Komuna e P. e bashkëngjiti Autorizimin nr.02-216-7040 të datës 28 janar 2014, në të cilin thuhet se F.R. si përfaqësues ligjor i Komunës së P.

është i autorizuar që ta përfaqësojë Komunën para të gjitha gjykatave lidhur me të gjitha lëndët ku Komuna është palë në procedurë.

17. Pala përgjegjëse në ankesë pretendoi se pronë e kërkuar ka qenë dhe ende është e regjistruar si pronë komunale.
18. Duke u bazuar në palën përgjegjëse në ankesë, pala ankuese pretendon se pronë e kërkuar është transferuar në emër të babait të saj në vitin 1992 në regjistrat kadastral të zhvendosur nga Kosova në Serbi. Sipas ligjeve në fuqi para dhe pas konfliktit, pronë që ndodhet përbrenda territorit komunal mund të transferohet vetëm përbrenda të njëjtit territor komunal ku ndodhet pronë. Prandaj, pala përgjegjëse në ankesë kërkon që ankesa të refuzohet si e pabazuar.
19. Provat e njëjta që janë shqyrtuar nga shkalla e para i janë bashkëngjitur përgjigjes ndaj ankesës.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

20. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh sikurse parashihet me Ligjin nr. 03/L-079, neni 12.1, dhe është i pranueshëm.

Meritat e ankesës

21. Gjykata Supreme e Kosovës e shqyrtoi ankesën në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.03/L-006 (më tutje: LPK), dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë konstatoi se ankesa është e pabazuar.
22. Vendimi i KKPK-së duhet të anulohet *ex officio* pasi që lënda nuk bie nën juridiksionin e saj. KKPK-ja nuk është dashur të vendosë mbi meritat e lëndës por ta hedh poshtë - neni 11.4 (b) i Ligjit nr. 03/L-079. Pasi që kjo nuk është bërë, vendimi i ankimuar *ex officio* duhet të anulohet dhe kërkesa të hidhet poshtë (argumenti sipas nenit 198 (1) të LPK-së që zbatohet *mutatis mutandis* për procedurën para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079. Sipas nenit 198 (1) të LPK-së, nëse shkalla e parë ka

marrë një Vendim mbi kërkesën që nuk është në juridiksionin e saj, gjykata e shkallës së dytë duhet ta anulojë atë Vendim dhe ta hedh kërkesën poshtë.

23. Në rastin konkret, pala ankuese konsideron se babai i saj i ndjerë u bë pronar i pronës. Ajo paraqet fletën poseduese nr.140 të datës 26 prill 2007 që është lëshuar nga Kadastrri i Zhvendosur në Kruševac, Serbi.
24. KKPK-ja ka dhënë një vendim të vërtetuar më 27 nëntor 2013. Vendimi i referohet “paragrafëve relevant” në Vendimin Grupor. Paragrafi nr.49 i Vendimit thotë:

“Komisioni vëren se ka mospërputhje ndërmjet regjistrave në zyrën kadastrale në P. dhe atyre në arkivat kadastrale për P. të zhvendosura në Serbi. Ndërsa prona e kërkuar është e regjistruar si pronë komunale në arkiva në Kosovë, Bartësi i pretenduar i të Drejtës Pronësore identifikohet si pronar në arkivin e zhvendosur. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk ka qenë në gjendje të gjejë ex officio ndonjë dokument mbështetës me qëllim të konstatimit të bazës për regjistrim në ndonjërin nga arkivat kadastrale, e as nuk janë ofruar ato nga ndonjëra palë. Si rrjedhojë, Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur ta verifikojë bazën sipas të cilës Paraqitësi i kërkesës gjoja e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar dhe si të tillë bazën për regjistrimin e pronës së kërkuar në emër të Paraqitësit të kërkesës në arkivat e zhvendosura”

25. Sipas nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (GZ RSFJ, Nr. 6/1980), që ishte në fuqi në kohën e transferimit të pretenduar të pronës (sikurse u theksua nga pala ankuese, kjo ndodhi në vitin 1990), e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të transferit juridik (veprimit juridik) dhe me trashëgim.
26. Për shkak se është konstatuar se ka mospërputhje ndërmjet regjistrave në Zyrën Kadastrale në Podujeve dhe atyre në Arkivat Kadastrale të Zhvendosura në Kruševac, Serbi, për Komunën e P. , Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kërkoi nga pala ankuese që ta dorëzojë dokumentin që ka shërbyer si bazë juridike për transferimin e pronës së kërkuar në emër të babait të saj.
27. Pala ankuese, ndonëse e kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive, nuk ka ofruar ndonjë dokument tjetër për ta dëshmuar bazën ligjore për transferimin e të drejtës së pronësisë në emër të babait të saj. As Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë provë ex officio, pavarësisht përpjekjeve të saj për të gjetur. Kjo e shpie Gjykatën në konkludimin se nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nenin 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (GZ RSFJ, Nr. 6/1980).

28. Në fazën e apelit, pala ankuese deklaroi se babai i saj e fitoi të drejtën e pronësisë në bazë të Aktgjykimit nr.39/90 të lëshuar nga Gjykata Komunale e P. më 24 maj 1990 që u bë i formës së prerë më 27 shkurt 1991, por pa e ofruar Aktgjykimin e pretenduar.
29. Megjithatë, neni 12.11 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh:
“Faktet dhe provat materiale të reja të paraqitura nga cilado palë e ankesës nuk do të pranohen dhe shqyrtohen nga Gjykata Supreme, përveç nëse demonstrohet se faktet dhe provat e tilla nuk kanë mundur të dihen në mënyrë të arsyeshme nga pala përkatëse”. Pala ankuese shumë lehtë ka mundur ta ndajë këtë informatë me Sekretarinë Ekzekutive në shkallën e parë; prandaj, Gjykata nuk do ta shqyrtojë deklaratën e palës ankuese.
30. Aktualisht, prona e kërkuar është e regjistruar si pronë shoqërore në emër të Kuvendit Komunal të P. .
31. Pasi që pala ankuese nuk ka arritur ta dëshmojë të drejtën e pronësisë të babait të saj mbi pronën e kërkuar, Gjykata Supreme konstaton se prona e kërkuar është ose pronë publike ose shoqërore. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, kompetenca e KKPK-së është e kufizuar në “pronën e paluajtshme private”. Prandaj, Kërkesa e palës ankuese bie jashtë juridiksionit të KKPK-së.
32. Në bazë të lartcekurave, dhe në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit nr.03/L-079 dhe nenin 198.1 të LPK-së, Gjykata ka vendosur sikurse në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.
33. Në përputhje me nenin 3.2 të Ligjit nr.03/L-079, pala ankuese ka të drejtë që para gjykatës me juridiksion kompetent ta paraqes kërkesën që nuk përfshihet në kërkesat e përshkruara në nenin 3.1 të këtij ligji.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr.03/L-079, ky Aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it